URDHËR
Nr.304, datë 8.5.2020

"PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË URDHËRIN NR.279, DATË 25.4.2020 "PËR LEHTËSIMIN E POSAÇËM TË LËVIZJES NË "ZONAT E GJELBËRTA"

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 7, të ligjit nr.15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga COVID-19, vendimit të Komitetit Teknik nr. 2225, datë 8.5.2020,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 279 datë 25.04.2020 "Për lehtësimin e posaçëm të lëvizjes në "Zonat e Gjelbërta", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1, pas fjalës "Vlorë" shtohen fjalët "Lushnjë, Patos, Roskovec, Korçë, Has, Kukës, Lezhë, Mirditë, Fushë Arrëz, Malësi e Madhe, Pukë, Vau i Dejës, Kavajë, Vorë, Rrogozhinë, Peqin".
2. Në pikën 3, orari 17:30 zëvendësohet me orarin 21:00.
3. Pika 6 riformulohet si vijon:

"6. Lejohet lëvizja e mjeteve private, pa autorizim, vetëm brenda qarku ose bashkisë së zonave të gjelbërta, nga ora 09:30 deri në orën 21:00, vetëm me pasagjer anëtarët e familjes."

4. Pas pikës 6 shtohet 6/1, me këtë përmbajtje:

"6/1 Aktivitetet e lejuara sipas përcaktimeve të bëra në udhrin nr. 193, datë 20.3.2020 "Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, për zonat e gjelbërta do të ushtrojnë veprimtarinë e tyre deri në orën 21:00".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu